



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kujtim Pasuli e Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Iniciativës Qytetare "Lidhja e Prishtinës", me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.Protokolli 01/2131/2025, të datës 16.08.2025, për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 18.08.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET e bazuar ankesa e Iniciativës Qytetare "Lidhja e Prishtinës", me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.Protokolli 01/2131/2025, të datës 16.08.2025, për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

II. ANULOHET Vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me Nr.Protokolli 01/2131/2025, të datës 16.08.2025, **URDHËROHET** Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), ta certifikojë Iniciativën Qytetare "Lidhja e Prishtinës", me seli në Prishtinë, sipas Rekomandimt të Zyrës për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ-së i datës, 16.08.2025, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 17.08.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga Iniciativa Qytetare "Lidhja e Prishtinës", me seli në Prishtinë, me të cilën theksohet se kundërshton vendimin e KQZ-së të datës 16.08.2025, me nr. 01/2131-2025, për shkak të aplikimit të gabuar të nenit 22 të Ligjit Nr. 08/1--228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullës Zgjedhore Nr. 01/2024.

Në ankesë pala ka theksuar se Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (më tutje: Zyra), ka rekomanduar KQZ-së certifikimin e Iniciativës Qytetare "Lidhja e Prishtinës". Pavarësisht këtij rekomandimi të Zyrës, KQZ nuk e ka miratuar certifikimin e Iniciativës Qytetare "Lidhja e Prishtinës", duke u bazuar në argumentet e ngritura nga anëtari i KQZ-së përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), sipas të cilit

slogani i Iniciativës Qytetare "Lidhja e Prishtinës" është i ngjashëm me një Slogan që ka përdorur LDK në zgjedhjet e vitit 2017. Neni 22 i këtij ligji përcakton qartë se emrat "identik apo të ngjashëm" nuk certifikohen vetëm nëse janë të ngatërrueshëm, mashtrues ose mund të krijojnë konfuzion me ndonjë subjekt tjetër politik. Në rastin konkret, emri "Lidhja e Prishtinës" nuk është identik dhe nuk shkakton asnjë ngatërrim me asnjë subjekt politik të regjistruar. Ky emër është i përqendruar në nivel lokal dhe nuk ngjan me asnjë subjekt të mëparshëm. Për më tepër, termit "Lidhje" dhe "Prishtinë" janë fjalë të përgjithshme, të cilat nuk gëzojnë mbrojtje ekskluzive dhe mund të përdoren lirisht nga çdo iniciativë qytetare, për aq kohë sa nuk përdoren në mënyrë mashtruese apo për të imituar ndonjë subjekt ekzistues. As Ligji Nr. 08/1--228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe as Rregulla Zgjedhore Nr. 01/2024 nuk e parashohin sloganin si kriter për refuzimin e regjistrimit të një iniciative politike. Rregulla Zgjedhore Nr. 01/2024, në nenin 4 paragrafi 1.5, përmend vetëm emrin, akronimin ose simbolin si elemente që mund të shërbejnë si arsye për refuzim të certifikimit. Për këtë arsye, përfshirja e sloganit si argument për të refuzuar ose penguar certifikimin e Iniciativës Qytetare "Lidhja e Prishtinës" përbën një veprim në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, si parim universal që siguron sigurinë dhe parashikueshmërinë juridike.

Edhe nëse pretendohet se slogani i përdorur nga Iniciativa Qytetare "Lidhja e Prishtinës" krijon hutim me ndonjë slogan të përdorur nga parti politike para tetë viteve, në një proces zgjedhor të kaluar, një pretendim i tillë nuk ka asnjë bazë ligjore. Ligji nuk i njeh partive politike të drejtën për pronësi të përhershme mbi fjalë apo slogane të përdorura në një fushatë të caktuar, aq më tepër kur këto janë të largëta në kohë dhe të kufizuara në kontekstin e një procesi zgjedhor të caktuar. Kësisoj, çdo arsyetim mbi bazën e sloganeve të dikurshme bie ndesh me ligjin dhe nuk mund të justifikojë refuzimin e certifikimit të një iniciative qytetare.

Refuzimi i certifikimit ose imponimi i ndryshimit të emrit të një iniciative qytetare cenon drejtpërdrejt të drejtën kushtetuese për pjesëmarrje në zgjedhje, siç është e garantuar nga neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Çdo kufizim i kësaj të drejte duhet të bazohet në kriteret e qarta ligjore, të jetë i domosdoshëm dhe proporcional me qëllimin që synon të arrijë. Në rastin konkret, kufizimi i vendosur ndaj Iniciativës Qytetare "Lidhja e Prishtinës" nuk është i justifikuar, pasi nuk ekziston asnjë rrezik real që emri apo identiteti i saj të shkaktojë ngatërrim me subjektet e tjera politike. Për rrjedhojë, një vendim i tillë paraqet një ndërhyrje të tepruar dhe joproporcionale në ushtrimin e të drejtave politike, duke vendosur pengesa të pajustificuara në pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin zgjedhor.

Zyra, në rekomandimin e saj të datës 15 gusht 2025, ka elaboruar qartë se, pavarësisht se fillimisht ka kërkuar nga subjekti aplikues të ndërrojë emrin e subjektit, e gjithë kjo është bërë duke marrë për bazë precedentin e krijuar në Zgjedhjet Lokale 2021. Ky precedent lidhet me subjektin aplikues "Dekada e Re për Drenasin", i cili më pas e kishte ndryshuar emrin në "Iniciativa Qytetare Dekada e Re për Drenasin".

Andaj, duke u bazuar në sa më sipër, Zyra ka konstatuar se rekomandimi i saj nuk bie në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe është në përputhje me praktikat evropiane.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar se në përputhje me Planin Operacional të aprovuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 12 Tetor 2025, periudha e aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për ka filluar më 26 qershor 2025 dhe përfundoi më 13 gusht 2025. Subjekti politik që ka aplikuar si iniciativë qytetare Lidhja e Prishtinës ka përfunduar të gjithë hapat e aplikimit për certifikim përmes platformës elektronike më 13 gusht 2025. Ky subjekt politik ka paraqitur kandidaturë për Kuvendin e Komunës në komunën e Prishtinës. Siç përcaktohet me Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2024 për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe të Kandidatëve të tyre, subjekti politik ka përmbushur të gjitha obligimet përmes dorëzimit të dokumentacionit të mëposhtëm: Deklarata politike, kodi i mirësjelljes, lista e kandidatit të subjektit politik, librezat me nënshkrimet e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë (186) mbështetësve, formulari i certifikimit të kandidatit, fletëpagesën për taksën e certifikimit. Gjatë periudhës së aplikimit për certifikim Zyra, pas pranimit të ankesave verbale nga përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkoi nga subjekti aplikues ta ndërroj emrin e subjektit përmes shkresës së dërguar më 31 korrik 2025. Subjekti Politik Lidhja e Prishtinës ka kthyer përgjigje me datën 01.08.2025 duke theksuar se nuk konsideron se emri i subjektit të tyre ka ngjajshmëri me emrin e ndonjë subjekti tjetër të certifikuar nga KQZ. Bazë për kërkesën e ndërrimit të emrit ishte precedenti i krijuar në Zgjedhjet Lokale 2021, që lidhet me subjektin aplikues Dekada e Re për Drenasin, e cila më pastaj e ndërroi emrin në Demokratët për Drenasin, si rezultat i mbledhjes së Këshillit për Çështje Ligjore (Mbledhja Nr. 21/ 2021, datë 27.08.2021) ku me shumicë të votave, u vendos të kërkohet nga subjekti aplikues Dekada e Re për Drenasin pëf ndryshimin e emrit, sepse ngjason me platformën politike të Partisë Demokratike të Kosovës Dekada e Re.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, paragrafi 1 i nenit 22, KQZ-ja nuk e certifikon subjektin politik me emër apo akronim që është i njëjtë, apo sipas gjykimit të KQZ-së, është i ngatërrueshëm, mashtrues ose i ngjashëm me, emrin apo akronimin me të cilin një subjekt tjetër politik është certifikuar më herët. Duke pasur parasysh që pretendimet e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kanë të bëjnë me ngjashmërinë e emrit të subjektit politik me sloganin e përdorur në Zgjedhjet e vitit 2017 si dhe pretendim që ky slogan përpos në Zgjedhjet e vitit 2017, përdoret nga Lidhja Demokratike e Kosovës për një periudhë tashmë gati tridhjetë (30) vjeçare, Zyra ka konsultuar praktikën europiane në çështjet e kontesteve të emrave të subjekteve politike. Zyra ka vënë re se sipas legjislacionit evropian në fuqi (Rregulla (EU, Euratom) Nr. 1141/2014 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian për Statutin dhe Financimin e Partive Politike Evropiane dhe Fondacioneve Politike Evropiane) ngjashmëritë nuk lejohen në mes të emrave dhe Ilogove të partive politike dhe secila parti duhet të ketë emfin dhe Ilogon qartësisht të dallueshme nga njëra tjetra. Me tutje sipas precedentëve të krijuar në Gjykatat europiane, Zyra ka vënë re se pavarësisht nëse një emërtim, slogan apo diqka e ngjashme, ka rëndësi kulturore, sociale e historike për një grup njerëzish apo në nivel vendi, nëse nuk është e sanksionuar me ligj, përdorimi i tyre nuk mund të ndalohet (Rasti Sarkozy/Les Republicains). Rastet e vetme të bllokimit janë ato kur është tentuar të përdoret një emër apo akronim i njëjtë apo i ngjashëm me një parti të regjistruar më herët (Rasti PRO DM kundër PRO në Gjermani). Zyra ka arritur në përfundim se platformat politike dhe sloganet e partive politike që janë përdorur në të kaluarën, nuk kategorizohen si ndalesa ligjore, nëse çfarëdo subjekti politik në zgjedhjet e radhës mund ta përdor emrin e ngjashëm si emërtim të subjektit politik, dhe emrat e tillë nuk bien ndesh me nenin 22 të Ligjit për

Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Nisur nga çfarë u tha më lartë, Zyra ka rekomanduar KQZ për certifikim të subjektit politik Lidhja e Prishtinës për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të 12 Tetorit 2025.

Me datën 16 Gusht 2025, KQZ mbajti takimin në të cilin u prezantua rekomandimi i Zyrës për certifikimin e subjektit politik Lidhja e Prishtinës. Pas diskutimeve në lidhje me çështjen e emrit, me ç'rast përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës prezantoi shqetësimet e tij për ngjashmërinë së emrit të subjektit politik Lidhja e Prishtinës me sloganin e partisë së tij. Pas përfundimit të diskutimeve, rekomandimi është hedhur në votim dhe ka marrë pesë (5) vota për, një (1) votë kundër dhe pesë (5) abstenime dhe si rezultat rekomandimi nuk mori votat e nevojshme për të kaluar duke pasur parasysh që sipas paragrafit 4 të nenit 63 të LZP, për tu certifikuar një Subjekt politik, duhet të marrë 2/3 e votave. Rrjedhimisht, certifikimi është refuzuar siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 17 të LZP dhe është marrë Vendimi 01 /2131-2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli ka vlerësuar se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se pala ankuese Iniciativa Qytetare "Lidhja e Prishtinës", për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, ka përfunduar aplikimin për certifikim si subjekt politik përfshirë edhe listën e kandidateve në Zyrën për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ. Sipas rekomandimit të datës 16.08.2025 të Zyrës së lartcekur, është rekomanduar se Iniciativa Qytetare "Lidhja e Prishtinës", së bashku me kandidatët e këtij subjekti politik i ka plotësuar kushtet ligjore për tu certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

Paneli ka gjetur se KQZ-ja, duke vendosur sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ ne mbledhjen e mbajtur me datë 16.08.2025, nuk e ka miratuar rekomandimin e Zyrës, për certifikimin e subjektit politik në fjalë, përkatësisht është konstatuar se rekomandimi për certifikimin Iniciativa Qytetare "Lidhja e Prishtinës", nuk ka kaluar, pasi që pas votimit 5 vota kanë qenë për, 1 votë ka qenë kundër dhe 5 abstenime, dhe si rezultat rekomandimi nuk mori votat e nevojshme për të kaluar duke pasur parasysh që sipas paragrafit 4 të nenit 63 të LZP, për tu certifikuar një Subjekt politik, duhet të marrë 2/3 e votave, edhe pse i njëjti subjekt i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore konform dispozitave të LZP-së.

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe të gjitha shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në vendimin e tij të datës 16.08.2025 me Nr.Protokolli 01/2131/2025, nuk mund ta pranoi si të drejtë dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë, meqenëse i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore që i referohen aplikimit dhe certifikimit të subjekteve politike, me konkretisht nenit 16 të LZP-së, i cili përcakton, Kushtet për certifikimin e subjekteve politike të cilat subjektet politike duhet të plotësojnë në mënyrë që të marrin pjesë në zgjedhje. Në nenin 16 paragrafi 5 parashihet se "*KQZ-ja e certifikon*

subjektin politik me të drejtë pjesëmarrjeje nëse i njëjti e dorëzon aplikimin e plotësuar, në formën e përshkruar dhe në datën e vendosur nga rregullat e KQZ-së.....”.

Me dispozitat e nenit 17 par. 1 i LZP-së parasheh se “Zyra shqyrton të gjitha aplikimet dhe nëse përcakton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kriteret të përcaktuara me nenin 16, të këtij ligji, atëherë Zyra është e obliguar që dhjetë (10) ditë pas pranimit të aplikimit për certifikim dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik lidhur për arsyen ose arsyet pse aplikimi i tij nuk është i mjaftueshëm”. Neni 17 par. 3 i LZP-së parasheh se “Zyra i bënë rekomandim me shkrim KQZ-së për apo kundër miratimit të secilit aplikim që pranon brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë. Rekomandimet përmbajnë shpjegim të shkruar për secilin kriter. Asnjë parti nuk certifikohet nëse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara më tutje”. Neni 17 par 4 i LZP-së parasheh se “pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ-ja e miraton ose e refuzon aplikimin për certifikim brenda shtatë (7) ditëve”.

Po ashtu edhe në Rregulloren Zgjedhore Nr.04/2024 të KQZ-së për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, përkatësisht në nenin 2 pika 2 shprehimisht parashihet që “Pas përmbushjes së kërkesave sipas paragrafit 1 të këtij neni, partia politike e regjistruar do të jetë automatikisht e certifikuar përveç nëse Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) konfirmon se një parti politike nuk i ka paguar gjokat e shqiptuara në zgjedhjet paraprake apo ndonjë detyrim tjetër, përfshirë këtu edhe gjokat e shqiptuara nga KQZ apo është sanksionuar sipas nenit 15 të Rregullores Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe funksionimi partive politike”.

Në rastin konkret Paneli vërtetoi se Iniciativa Qytetare “Lidhja e Prishtinës” ka dorëzuar aplikimin e kompletuar, në përputhshmëri bazuar në nenet 16 dhe 17 të LZP-së, andaj KQZ-ja është e obliguar që të certifikoj çdo subjekt politik i cili i plotëson kushtet e parapara ligjore siç i ka plotësuar në rastin konkret Iniciativa Qytetare “Lidhja e Prishtinës, për çka e njëjta është rekomanduar për certifikim edhe nga Zyra për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ. Sipas vlerësimit të panelit emri i Iniciativa Qytetare “Lidhja e Prishtinës”, nuk është identik dhe nuk shkakton asnjë ngatërrim me asnjë subjekt politik të regjistruar në KQZ. Poashtu edhe slogani i Iniciativës Qytetare “Lidhja e Prishtinës”, nuk është identik apo i ngjashëm ose mashtrues dhe nuk mund të shkaktoj ngatërrim apo ç'orientim tek votuesit.

Andaj Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi konform neneve: 53 paragrafi 1, 131 paragrafi 4, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh “Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. Me nenin 131 par. 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet “Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulohet apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala”.


Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se vendimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, dhe

urdhëroi KQZ-në, që të zbatoj vendimin e PZAP-it konform dispozitës së nenit 118 par. 5 të LZP-së.

Në pajtim me nenin 115 par. 1 lidhur me nenin 118 par. 1 dhe 5 të dhe 119 LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.2/2025, datë: 18.08.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.